



RRJETI I  
SHËRBIMEVE  
**SOCIO-SHËNDETËSORE**



● Bashkia Elbasan



RRJETI I  
SHËRBIMEVE  
**SOCIO-SHËNDETËSORE**

Bashkia **Elbasan**

Informacioni u mblodh nga  
Shoqata “Rrjeti i Informimit dhe Qytetarisë Aktive”



Hartimi dhe publikimi i këtij dokumenti u realizua me mbështetjen e Projektit  
“Shëndet për të Gjithë” të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC”



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC



# Tabela e Përmbajtjes

<b>Hyrje</b>	<b>5</b>
<b>Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Elbasan</b>	<b>6</b>
<b>Bashkia Elbasan</b> Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	<b>10</b>
<b>Bashkia Elbasan</b> Shërbimi Social në Njësitë Administrative	<b>12</b>
<b>Qendra Sociale Balashe</b> Shërbimi i përkujdesjes për të moshuarit	<b>16</b>
<b>Spitali Psikiatrik “Sadik Dinçi”</b>	<b>18</b>
<b>Spitali Rajonal Elbasan</b> Njësia e Shërbimit Paliativ dhe Kimioterapisë	<b>20</b>
<b>Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor</b>	<b>22</b>
<b>Fondacioni Aid to Balkans (A2B)</b> Qendra Ditore për të Moshuar “Buka e Jetës”	<b>24</b>
<b>Fondacioni Aid to Balkans (A2B)</b> 1. Qendra Sociale Ditore “Hope for the Future” 2. Apartamente sociale për të rinjtë “Shtëpia e Mundësive”	<b>26</b>
<b>Aid to Balkans (A2B)</b> Mbështetje për të sëmurët kronikë	<b>30</b>
<b>Forumi i Gruas Elbasan (FGE)</b> Shërbim Psiko-social Shërbim i Këshillimit Ligjor	<b>32</b>
<b>Forumi i Gruas Elbasan (FGE)</b> Strehëza e Emergjencës për Rastet e Dhunës	<b>34</b>
<b>Shoqata “Tjetër Vizion”</b> Qendër Ditore për Gratë Viktima të Dhunës	<b>36</b>
<b>Shoqata “Tjetër Vizion”</b> Qendra Rezidenciale për të Mitur Viktima të (Mundshme të) Trafikimit	<b>38</b>
<b>Shoqata “Tjetër Vizion”</b> Zyra për Këshillimin e Burrave dhe Djemve Dhunues	<b>40</b>
<b>“Zonja e Këshillit të Mirë”</b>	<b>42</b>
<b>Kisha Katolike Famullia Shën Piu 10</b>	<b>44</b>
<b>Kisha Ortodokse</b>	<b>46</b>



# Hyrje

Rrjeti i Shërbimeve Socio-Shëndetësore në Bashkinë Elbasan është një nismë e mbështetur nga Projekti “Shëndet për të Gjithë” i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), në zbatim të “Strategjisë Kombëtare të Kujdesit Shëndetësor Parësor” 2020-2025. Dokumenti synon të fuqizojë shërbimin socio-shëndetësor në Kujdesin Shëndetësor Parësor (KSHP), përmes përmirësimit të qasjes dhe cilësisë së shërbimeve sociale, veçanërisht të atyre që synojnë arritjen e popullatave të cënueshme.

Ky dokument përbën një mjet pune që u vjen në ndihmë punonjësve socialë pranë KSHP-së për të lidhur ose referuar pacientët drejt shërbimeve plotësuese, që nuk mund të ofrohen nga Qendrat Shëndetësore. Njëkohësisht, ky dokument u vjen në ndihmë aktorëve të tjerë lokalë të shërbimeve sociale dhe shëndetësore, si Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale në Bashki, Shërbimi Social Shtetëror Rajonal dhe Organizatat e Shoqërisë Civile në Bashkinë Elbasan, duke u mundësuar njohjen dhe koordinimin më të mirë të shërbimeve në zonën e tyre të mbulimit.

Rrjeti i Shërbimeve Shëndetësore dhe Sociale në Bashkinë Elbasan u përgatit nga Shoqata “Rrjeti i Informimit dhe Qytetarisë Aktive” Elbasan gjatë periudhës Nëntor – Dhjetor 2023.

Për realizimin e këtij dokumenti, falendërojmë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale në Bashki, Shërbimin Social Shtetëror Rajonal dhe Organizatat e Shoqërisë Civile në Bashkinë Elbasan, si bashkëpunëtorë të rëndësishëm në jetësimin e këtij procesi.

# ○ Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Elbasan

**Lloji i institucionit** Publik

**Adresa** Rruga "Faik Pajuni", Lagjja Kongresi i Elbasanit, Pall. 35/3, Elbasan  
sherbimisocial.gov.al/drejtorige-rajonale  
Tel.: 054 510 501 | drejtoriasshelbasan@gmail.com

**Përfaqësues ligjor i institucionit** **Etleva Mezini**  
Cel.: 00355 67 56 18406 | etleva.mezini@sherbimisocial.gov.al

**Personi i kontaktit** **Etleva Mezini**  
Drejtoreshë e DRSHSSH Elbasan

**Mbulimi gjeografik** Rajonal (7 Bashki: Peqin, Elbasan, Belsh, Gramsh, Librazhd, Prrenjas, Cërrik)

**Koha e ofrimit të shërbimit** Prej vitit 1996

## ○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- **Qëllimi i shërbimit**
  - Rritja e cilësisë së jetës për personat vulnerabël në rajonin e Elbasanit.
- **Fushat e shërbimeve**
  - Shërbime shoqërore (Institucione të Përkujdesjes Sociale)
  - Shërbime të pagesave për Ndhimë Ekonomike dhe Aftësinë e Kufizuar
- **Llojet e shërbimeve**

Shërbime shoqërore (Institucione të Përkujdesjes Sociale):

  - Monitorim të standardeve të shërbimeve sociale në rajon të ofruara nga Institucionet e Përkujdesjes Sociale, publike dhe jopublike, rezidenciale dhe ditore që ofrojnë shërbime për fëmijët (të trafikuar, me probleme social-ekonomike), të rritur (me probleme social-ekonomike), të moshuarit 65+, gratë e dhunuara;

Shërbime të pagesave për Ndhimë Ekonomike dhe Aftësinë e Kufizuar:

  - Administrim të Regjistrimit Elektronik për aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror (përfshirë dosjet e të moshuarve për azil);
  - Programim dhe detajim të fondeve të ndihmës ekonomike (shqyrton dosjet e përfituesve);
  - Programim dhe detajim të fondeve të pagesës për personat me aftësi të kufizuar (shqyrton dosjet e përfituesve);
  - Shpërndarja e bonusit të foshnjës.



## Shërbimet e monitoruara nga DRSHSSH Elbasan

### Shërbime Sociale për Fëmijë:

- Shërbime Rezidenciale për Fëmijë (3 qendra)
- Shërbime Ditore për Fëmijë (4 qendra)

### Shërbime Sociale për të Moshuar:

- Shërbime Rezidenciale për të Moshuar
- Shërbime Ditore për të Moshuar (2 qendra)

### Shërbime për Persona me Aftësi të Kufizuar:

- Shërbime Rezidenciale për PAK
- Shërbime Ditore për PAK (3 qendra)

### Shërbime Sociale për Gra të Dhunuara/Viktima Trafikimi:

- Shërbime Rezidenciale & Ditore (1 qendër)
- Shërbime Rezidenciale (1 qendër)

### Shërbime të tjera Komunitare (5 qendra):

- “Tjetër Vizion” Qendra Ditore për Gra
- “Tjetër Vizion” Qendra Rinore
- “World Vision”
- Shoqata “Në Dobi të Gruas Shqiptare”
- Fondacioni “Aid to the Balkans”, Projekti “Lidhjet me Familje”

## GRUPET PËRFITUESE

### Kategoritë përfituese

- Fëmijët
- Familjet
- Personat me aftësi të kufizuar
- Të moshuarit
- Gratë e dhunuara/viktimat e trafikimit

### Kriteret kualifikuese

#### Për fëmijët:

- Jetimë që nuk janë në institucione
- Fëmijë të vendosur në shërbimin e kujdestarisë

#### Për përfituesit e ndihmës ekonomike:

- Të papunë
- Kryefamiljarë
- Persona që jetojnë në kushte minimale të jetesës
- Persona që nuk zotërojnë pasuri të paluajtshme si shtëpi të dytë, vila, makina
- Familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme

#### Për përfituesit e pagesës së Aftësisë së Kufizuar:

- Paraplegjikë ose tetraplegjikë
- Persona me aftësi të kufizuar ose të paaftë për punë
- Invalidët e punës
- Rezidentë të qarkut të Elbasanit

Për të moshuarit:

- Të moshuar 65+
- Të vetmuar
- Të moshuar që nuk zotërojnë pasuri të paluajshme (tokë, shtëpi)

Për gra të dhunuara/viktima të trafikimit:

- Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre;
- Viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes;

## Identifikimi i përfituesve

- Përmes shërbimeve publike të përkujdesjes dhe mbështetjes sociale në rajon

## INFORMACION ADMINISTRATIV

### Numri i punonjësve

- 15 punonjës

### Financuesi i shërbimit

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

### Burime të tjera të ardhurash

- Kontributet nga donacione e sponsorizime

### Pagesa nga përfituesit

- Nuk ka

### Koordinimi me shërbime të tjera

- Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale në Bashkinë Elbasan
- Njësitë Administrative për përfituesit e ndihmës ekonomike
- Mjekët e familjes dhe specialistët për skemën e Aftësisë së Kufizuar
- Institucione të tjera publike që kanë fokus grupet përfituese (sikundër përmenden institucionet referuese)
- Inspektorati i Punës
- Organizata ndërkombëtare dhe lokale që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve, familjeve, dhe fuqizimin e komuniteteve.















# Bashkia Elbasan

## Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale

<b>Lloji i institucionit</b>	Publik
<b>Adresa</b>	Rruga “Qemal Stafa”, Bashkia Elbasan   <a href="http://www.elbasani.gov.al">www.elbasani.gov.al</a>
<b>Përfaqësues ligjor i institucionit</b>	<b>Blendi Musaj</b> Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale Cel.: 00355 69 40 40455   Email: <a href="mailto:blend.musaj@elbasani.gov.al">blend.musaj@elbasani.gov.al</a>
<b>Personi i kontaktit</b>	<b>Blendi Musaj</b> Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale
<b>Mbulimi gjeografik</b>	Bashkia Elbasan 12 Njësi Administrative Rurale: Papër, Gjergjan, Shirgjan, Shushicë, Gjinar, Bradashesh, Labinot-Mal, Labinot-Fushë, Funar, Gracen, Tregan, Zavalinë, dhe 6 Lagje Urbane: Lagjja 1, Lagjja 2, Lagjja 3, Lagjja 4, Lagjja 5, Lagjja 6
<b>Koha e ofrimit të shërbimit</b>	Prej vitit 2014 (i unifikuar sipas reformës administrative)

### INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

-  **Qëllimi i shërbimit**  Rritja e cilësisë së jetës për banorët e Bashkisë Elbasan
-  **Fushat e shërbimeve**  Administrim dhe monitorim të shërbimeve sociale
-  **Llojet e shërbimeve** **Shërbime sociale:**
  -  Administrim dhe monitorim i qendrave ditore dhe rezidenciale që ofrojnë shërbime sociale dhe shëndetësore të (bashkë) financuara nga Bashkia Elbasan;
  -  Koordinim të rrjetit të organizatave dhe institucioneve publike dhe jopublike, operuese në territorin e Bashkisë Elbasan;
  -  Ofrim i strehimit social për familjet në nevojë;
  -  Ofrim i pakove ushqimore për familjet në nevojë;
  -  Identifikim, shqyrtim dhe menaxhim rastesh për grupet sociale në rrezik si: fëmijët, të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe minoritetet për përfitim të shërbimeve sociale;
  -  Identifikim i familjeve të varfëra dhe referimi për ofrimin e ndihmës ekonomike;
  -  Parandalim, identifikim, vlerësim, mbrojtje dhe ndjekje e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje dhe viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;

## GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese**
  - ↳ Fëmijët
  - ↳ Gratë
  - ↳ Familjet
  - ↳ Të moshuarit
  - ↳ Të rriturit
  - ↳ Komuniteti Rom dhe Egjiptian
- Kriteret kualifikuese**
  - ↳ Familje të varfëra dhe me vështirësi të mëdha sociale, ekonomike, shëndetësore, me shumë fëmijë, etj.;
  - ↳ Persona me aftësi të kufizuara (pavarësisht llojit të paaftësisë);
  - ↳ Të moshuar, që jetojnë vetëm, pa të ardhura të mjaftueshme, etj.;
  - ↳ Fëmijë dhe gra të dhunuara, viktime të dhunës në familje, trafikimit, etj.;
  - ↳ Fëmijë jetimë;
  - ↳ Të rinj të dalë nga qendra rezidenciale;
- Identifikimi i përfituesve**

Identifikimi i personave në nevojë kryhet nga:

  - ↳ Njësia e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave në këtë drejtori
  - ↳ Njësitë Administrative në Bashkinë Elbasan
  - ↳ Identifikimi si pasojë e referimit nga institucionet më poshtë

## INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve**
  - ↳ 9 punonjës
- Financuesi i shërbimit**
  - ↳ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
  - ↳ Bashkia Elbasan
- Burime të tjera të ardhurash**
  - ↳ Organizatat Jofitimprurëse që veprojnë në bashkinë Elbasan.
- Pagesa nga përfituesit**
  - ↳ Nuk ka
- Koordinimi me shërbime të tjera**
  - ↳ Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
  - ↳ Policia e Shtetit/Prokuroria/Gjykata
  - ↳ Inspektoriati i Punës
  - ↳ Zyra Vendore Arsimore
  - ↳ Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
  - ↳ Organizata Jofitimprurëse
  - ↳ Organizata me Bazë Fetare
  - ↳ Organizata ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri

# **Bashkia Elbasan**

## Shërbimi Social në Njësitë Administrative

Kjo fishë përmban informacion për Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan:

- Lagjja 2
- Lagjja 5
- Njësia Administrative Papër
- Njësia Administrative Shirgjan

**Lloji i institucionit** Publik

**Adresa** Lagjja 2: “Brigada 17 Sulmuese”  
Lagjja 5: Lagjja 5  
Njësia Administrative Papër, km 13 Autostradë  
Njësia Administrative Shirgjan, Fshati Kuqan, Elbasan

**Përfaqësues ligjor i institucionit** **Elsid Zyma:** 00355 69 65 37966 | Email: [elsid.zyma@elbasani.gov.al](mailto:elsid.zyma@elbasani.gov.al)  
**Dritan Pisha:** Cel.: 00355 69 23 41837 | Email: [dritan.pisha@elbasani.gov.al](mailto:dritan.pisha@elbasani.gov.al)  
**Erald Gjeli:** Cel.: 00355 69 57 05695  
**Ylli Dushku:** Cel.: 00355 69 27 77971

**Personi i kontaktit** **Ejona Niça**  
Cel.: 00355 69 57 26495 | [ejona.nica@elbasani.gov.al](mailto:ejona.nica@elbasani.gov.al)

**Beatrice Pajova**  
Cel.: 0355 69 43 10347 | [beatrice.pajova@elbasani.gov.a](mailto:beatrice.pajova@elbasani.gov.a)

**Englantina Doko**  
Cel.: 00355 69 37 01306 | [egladoko@gmail.com](mailto:egladoko@gmail.com)

**Xhanina Nërpetri**  
Cel.: 00355 69 76 98060 | [xhanina.nerpetri@elbasani.gov.al](mailto:xhanina.nerpetri@elbasani.gov.al)

**Mbulimi gjeografik** Lagjja 2, Lagjja 5, Njësia Administrative Papër dhe Shirgjan

**Koha e ofrimit të shërbimit** Prej vitit 2014

## **INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE**

 **Qëllimi i shërbimit**

- Jetesë cilësore për banorët e zonave të mbulimit

 **Fushat e shërbimeve**

- Shërbime Sociale
- Shërbime Administrative

## Llojet e shërbimeve

### Shërbime Sociale:

- Funksionimi i Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit për grupet në nevojë
- Referim i rasteve pranë Grupit Teknik Ndërsektorial Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki
- Shërbime të tjera lehtësuese për kryefamiljarët në nevojë

### Shërbime Administrative:

- Mbështetje në procesin e aplikimit për ndihmën ekonomike
- Mbështetje në procesin e aplikimit për pagesën e paftësisë

## GRUPET PËRFITUESE

### Kategoritë përfituese

- Individët
- Familjet

### Kriteret kualifikuese

- Familje në vështirësi ekonomike, me probleme të theksuara sociale
- Të moshuarit, 65+
- Familje me probleme të aftësisë së kufizuar
- Individë, kryefamiljarë në vështirësi ekonomike, sociale, shëndetësore
- Persona me aftësi të kufizuar
- Banorë të lagjeve përkatëse

### Identifikimi i përfituesve

- Nëpërmjet Sistemit të Pikëzimit dhe verifikimit manual të dosjeve të aplikantëve dhe përfituesve të ndihmës ekonomike dhe paftësisë;
- Përbushja e kriterëve të vendosura në formularët standardë (për kategorinë e ndihmës ekonomike, personat 65+, fëmijë dhe gra të dhunuara);
- Vizitat në familje dhe vizita në komunitet;

## INFORMACION ADMINISTRATIV

### Numri i punonjësve

- Lagjja 2: 7 punonjës
- Lagjja 5: 7 punonjës
- Njësia Administrative Papër: 8 punonjës
- Njësi Administrative Shirgjan: 7 punonjës

### Financuesi i shërbimit

- Bashkia Elbasan

### Burime të tjera të ardhurash

- Nuk ka

- **Pagesa nga përfituesit**
  - Disa pagesa fillestare të miratuara me ligj dhe të afishuara për shërbime të caktuara
- **Koordinimi me shërbime të tjera**
  - Drejtorja e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, Bashkia Elbasan
  - Qendrat Shëndetësore dhe Spitali Rajonal
  - Lagjet e tjera të bashkisë Elbasan
  - Sporadikisht me donatorë dhe organizata jofitimprurëse





# Qendra Sociale Balashe

## Shërbimi i përkujdesjes për të moshuarit

**Lloji i institucionit** Publik

**Adresa** Rruga Balashe, Lagjja Shënkoll, Elbasan

**Përfaqësues ligjor i institucionit** **Edvin Palloshi**  
Cel.: 00355 69 74 44434 | Email: edvin.pallosi@elbasani.gov.al

**Personi i kontaktit** **Edvin Palloshi**  
Drejtor ekzekutiv

**Mbulimi gjeografik** Bashkia Elbasan

**Koha e ofrimit të shërbimit** Prej vitit 2001

## INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

**Qëllimi i shërbimit** ▼ Jetesë dinjitoze për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

**Fushat e shërbimeve** ▼ Shërbime rezidenciale dhe ditore për të moshuarit  
▼ Shërbime shëndetësore  
▼ Shërbime psiko-sociale

**Llojet e shërbimeve** **Shërbime rezidenciale dhe ditore për të moshuarit:**  
▼ Rezidencë për të moshuar;  
▼ Qendër ditore për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara;  
▼ Shërbim ditor në qendër me synim shoqërizimin: angazhim në sallën polivalente, zhvillim aktiviteteve krijuese, festa, lexim libri, domino, letra apo dhe ekskursionet;  
▼ Psikoterapi për frekuentuesit ditorë dhe të moshuarit e “Shtëpisë së të Moshuarve”;  
▼ Transport për frekuentuesit e qendrës;

### Shërbime shëndetësore:

▼ Shërbim infermieror për frekuentuesit e qendrës dhe ata që janë rezidentë;  
▼ Fizioterapi për frekuentuesit ditorë dhe të moshuarit e “Shtëpisë së të moshuarve” - palestër e pajisur me mjetet e duhura për fizioterapi;

**Shërbim në banesë për të moshuarit dhe ata me aftësi të kufizuara që nuk kanë mundësi të vijnë në qendër:**

▼ Dërgimi i vaktit ushqimor  
▼ Sporadikisht, përkujdesje për higjienën shtëpiake.

## GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese**
  - ↳ Të moshuarit
  - ↳ Personat me aftësi të kufizuara
- Kriteret kualifikuese**
  - ↳ Të moshuar të vetmuar, pa pronësi, me pension minimal ose invaliditeti (Shërbimi rezidencial)
  - ↳ Të moshuar që jetojnë vetëm në banesën e tyre me pamundësi lëvizjeje
  - ↳ Personat me aftësi të kufizuar (5-55 vjeç) frekuentues të qendrës ditore
  - ↳ Banorë të bashkisë Elbasan
- Identifikimi i përfituesve**
  - ↳ Përmes Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale në Bashki
  - ↳ Njësive Administrative
  - ↳ Institucioneve koordinuese sa më poshtë

## INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve**
  - ↳ 48 punonjës
- Financuesi i shërbimit**
  - ↳ Bashkia Elbasan
- Burime të tjera të ardhurash**
  - ↳ Organizata Jofitimprurëse
- Pagesa nga përfituesit**
  - ↳ Për shërbimin rezidencial “Shtëpia e të Moshuarve”, të moshuarit duhet të paguajnë 40% të pensionit.
- Koordinimi me shërbime të tjera**
  - ↳ Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Shëndetësor Parësor, Poliklinika e Specialiteteve, Spitali Rajonal
  - ↳ Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor
  - ↳ Drejtori e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale
  - ↳ Drejtoria Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror
  - ↳ Njësitë administrative, Lagjet
  - ↳ Policia e Shtetit
  - ↳ Organizatat Jofitimprurëse

# Spitali Psikiatrik “Sadik Dinçi”

<b>Lloji i institucionit</b>	Publik
<b>Adresa</b>	Rruga “Ismail Zyra”, Lagjja “Haxhias”, Elbasan
<b>Përfaqësues ligjor i institucionit</b>	<b>Zenun Bullari</b> Dretor i Spitalit Psikiatrik Cel.: 00355 68 267 2002   spelbasan@shendetesia.gov.al
<b>Personi i kontaktit</b>	<b>Adela Muca</b> Përgjegjëse e shërbimit psiko-social & rehabilitues Cel.: 00355 67 35 98939   Email: adela.lamcja@live.com
<b>Mbulimi gjeografik</b>	Rajonal (Bashkitë: Elbasan, Cërrik, Belsh, Gramsh, Librazhd, Peqin, Prrenjës, Librazhd).
<b>Koha e ofrimit të shërbimit</b>	Prej vitit 1964

## INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- Qëllimi i shërbimit**
  - Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me probleme të shëndetit mendor
- Fushat e shërbimeve**
  - Shërbim shëndetësor i shëndetit mendor me hospitalizim
  - Shërbim psiko-social
  - Shërbim riaftësimi
- Llojet e shërbimeve**
  - Shërbim shëndetësor i shëndetit mendor me hospitalizim:
    - Shërbime mjekësore diagnostikuese dhe trajtuese
    - Hospitalizim i personave 18 - 65 vjeç që vuajnë nga problemet e shëndetit mendor
  - Shërbim psiko-social:
    - Shërbime sociale dhe psikologjike (vlerësim psiko-social, ndërhyrje psiko-sociale, terapi okupacionale, dhe riaftësim gjatë periudhës së hospitalizimit)
  - Shërbim riaftësimi:
    - Akomodim i të sëmurëve në shtëpizat vartëse për rehabilitim (2 shtëpiza: Elbasan dhe Cërrik).

## GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese**
  - Personat 18 -65 vjeç
- Kriteret kualifikuese**
  - Persona që vuajnë nga çrregullimi psikiatrik akut apo kronik i pamenaxhueshëm në kushte ambulatorë
  - Grupmosha 18-65 vjeç
  - Çrregullimi psikiatrik të mos jetë nën nga përdorimi i substancave narkotike apo alkoolit
  - Banor i një prej bashkive të lartpërmendura
- Identifikimi i përfituesve**
  - Të jetë identifikuar, vlerësuar dhe diagnostikuar përmes sistemit publik mjekësor të referimit (Mjek familjeje -> Specialist i shëndetit mendor -> Spital)

## INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve**
  - 193 persona
- Financuesi i shërbimit**
  - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Burime të tjera të ardhurash**
  - Nuk ka
- Pagesa nga përfituesit**
  - Nuk ka
- Koordinimi me shërbime të tjera**
  - Bashkia Elbasan
  - Njësitë Administrative
  - Policia e Shtetit/Gjykata
  - Shërbimi Social Shtetëror
  - Qendrat shëndetësore të kujdesit shëndetësor parësor
  - Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor
  - Spitali Bashkiak/Rajonal
  - Organizata Jofitimprurëse

# Spitali Rajonal Elbasan

## Njësia e Shërbimit Paliativ dhe Kimioterapisë

**Lloji i institucionit** Publik

**Adresa** Spitali Rajonal Elbasan  
Lagjja Haxhias, Godina e Spitalit Patologjik, Kati i dytë

**Përfaqësues ligjor i institucionit** **Luljeta Vathi**  
Cel.: 00355 68 90 14518 | Email: lulivathi@yahoo.com

**Artan Çomo**  
Cel.: 00355 68 20 99037

**Personi i kontaktit** **Luljeta Vathi**  
**Artan Çomo**

**Mbulimi gjeografik** Rajonal (Bashkitë: Peqin, Elbasan, Belsh, Gramsh, Librazhd, Prrenjas, Cërrik)

**Koha e ofrimit ë shërbimit** Prej vitit 2014

## INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

**Qëllimi i shërbimit** ➤ Menaxhimi me dinjitet dhe lehtësimi i fazës terminale për pacientët dhe familjarët e tyre.

**Fushat e shërbimeve** ➤ Shërbim shëndetësor (paliativ dhe kimioterapi) në klinikë  
➤ Shërbim monitorues dhe përkujdesje në klinikë  
➤ Shërbim psikologjik në klinikë

**Llojet e shërbimeve** Shërbim shëndetësor (paliativ dhe kimioterapi):  
➤ Trajtim paliativ për personat me diagnoza onkologjike në stadi të avancuara;  
➤ Trajtim suportiv me perfuzione venoze dhe intravenoze;  
➤ Aplikim i skemave të kimioterapisë venoze, orale dhe të kombinuara;

**Shërbim monitorues dhe përkujdesje:**  
➤ Ndjekje dhe rikontrolle periodike të pacientëve paliativë;

**Shërbim psikologjik:**  
➤ Ndjekje psikologjike para, pas dhe gjatë terapisë për pacientin dhe familjarët;  
➤ Mbështetje psiko-sociale për familjarët e të sëmurëve;

## GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese**
  - ↘ Të sëmurët me kancer të referuar nga mjekët specialistë
- Kriteret kualifikuese**
  - ↘ Pacientë me kancer mbi moshën 14 vjeç
  - ↘ Pacientë rezidentë në qarkun e Elbasanit
- Identifikimi i përfituesve**

Përmes sistemit publik të referimit:

  - ↘ Mjeku i familjes referon tek mjeku specialist
  - ↘ Mjeku specialist referon për diagnozë imazherike apo laboratorike
  - ↘ Mjeku specialist onkolog e referon në qendrën paliative (sipas nevojës)

## INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve**
  - ↘ 6 persona
- Financuesi i shërbimit**
  - ↘ Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale
- Burime të tjera të ardhurash**
  - ↘ Nuk ka
- Pagesa nga përfituesit**
  - ↘ Nuk ka
- Koordinimi me shërbime të tjera**
  - ↘ Qendrat Shëndetësore nëpërmjet Mjekëve të Familjes
  - ↘ Poliklinika e Specialiteteve, Mjekët Onkologë
  - ↘ Spitali Rajonal Elbasan
  - ↘ Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

# Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor

**Lloji i institucionit** Publik

**Adresa** Rruga 28 Nëntori, Poliklinika e Specialiteteve, kati i tretë, Elbasan

**Përfaqësues ligjor i institucionit** **Noranda Biça**  
Cel.: 00355 67 22 69367

**Personi i kontaktit** **Daniela Çerjepi**  
Cel.: 00355 69 66 78889 | Email: cerjepidaniela@gmail.com

**Mbulimi gjeografik** Qarku Elbasan (Bashkitë: Cërrik, Peqin, Gramsh, Librazhd, Prrenjas, Belsh dhe Elbasan)

**Koha e ofrimit të shërbimit** Prej vitit 2008

## INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- Qëllimi i shërbimit**
  - Përmirësimi i mirëqënies emocionale, psikologjike dhe sociale për personat që kanë probleme të shëndetit mendor dhe komunitetin në tërësi
- Fushat e shërbimeve**
  - Shërbim shëndetësor
  - Shërbim psikologjik
  - Shërbim social
  - Shërbime parandaluese, edukuese dhe promovim shëndetësor
- Llojet e shërbimeve**
  - Shërbim shëndetësor
    - Diagnostikim dhe trajtim mjekësor i sëmundjeve mendore
    - Ndjekje të rastit dhe menaxhim të medikamenteve
    - Rekomadime për ekzaminime apo ndjekje të mëtejshme
    - Terapi infermierore në qendër dhe banesë (kryesisht injeksione)
    - Vlerësim multidisiplinor bio-psiko-social (bashkë me psikologun dhe punonjësin social)
    - Referim i rasteve të rënda në nevojë për hospitalizim në Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe Tiranë
  - Shërbim psikologjik
    - Vlerësime dhe raporte psikologjike
    - Ofrim i seancave të psikoterapisë
    - Mbështetje psikologjike dhe edukim mbi sëmundjen mendore për familjarët
    - Ndërlidhës me shërbime të tjera sipas nevojave



## Shërbim social

- Mbështetje në përgatitjen e dokumentacionit për procedurat e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP);
- Shoqërimi i pacienit në konsulta të tjera mjekësore
- Parandalim përmes edukimit shëndetësor individual, në grup dhe komunitet.

## GRUPET PËRFITUESE

- **Kategoritë përfituese** ➤ I gjithë komuniteti
- **Kriteret kualifikuese** ➤ Çdo anëtar i komunitetit me çrregullime të shëndetit mendor
- **Identifikimi i përfituesve** ➤ Përmes sistemit publik shëndetësor të referimit

## INFORMACION ADMINISTRATIV

- **Numri i punonjësve** ➤ 9 punonjës (staf multidisiplinar)
- **Financuesi i shërbimit** ➤ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- **Burime të tjera të ardhurash** ➤ Nuk ka
- **Pagesa nga përfituesit** ➤ Nuk ka
- **Koordinimi me shërbime të tjera**
  - Kujdesi Shëndetësor Parësor, përmes qendrave shëndetësore
  - Spitali Psikiatrik dhe ai Rajonal Elbasan
  - Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Elbasan
  - Njësitë Administrative dhe Lagjet, Bashkia Elbasan
  - Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
  - Policia e Shtetit
  - Shkollat dhe komuniteti
  - Organizata Jofitimprurëse

# ○ Fondacioni Aid to Balkans (A2B)

## Qendra Ditore për të Moshuar “Buka e Jetës”

<b>Lloji i institucionit</b>	Fondacion
<b>Adresa</b>	Rruga “Petraq Popa”, Lagjja “Brigada 17 Sulmuese”
<b>Përfaqësues ligjor i institucionit</b>	<b>Alketa Hasani:</b> Cel.: 00355 69 40 16712   Email: alketa.hasani@a2balbania.org Facebook: A2B Albania
<b>Personi i kontaktit</b>	<b>Ervehe Zeneli:</b> Cel.: 00355 68 80 07475
<b>Mbulimi gjeografik</b>	Elbasan
<b>Koha e ofrimit të shërbimit</b>	Prej vitit 1999

### ○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- **Qëllimi i shërbimit**
  - Jetesë me dinjitet për të moshuarit, veçanërisht ata në nevojë
- **Fushat e shërbimeve**
  - Shërbime sociale ditore dhe në banesë për të moshuarit
  - Shërbime mbështetëse për situatën shëndetësore
  - Shërbime psiko-sociale
- **Llojet e shërbimeve**
  - Shërbime sociale ditore dhe në banesë për të moshuarit:
    - Shërbime socializuese ditore në qendër për të moshuarit;
    - Ofrimi i vaktit ushqimor për të moshuarit;
    - Dërgimi i vaktit ushqimor në banesë për të moshuarit e vetmuar në pamundësi ardhjeje në mensë;
    - Në raste sporadike, të moshuarve u ofrohet ndihmë për higjienën personale dhe pastrim të banesës;
  - Shërbime mbështetëse për situatën shëndetësore:
    - Blerje të medikamenteve, kimoterapisë, për të moshuarit në pamundësi financiare;
    - Pagesa të vizitave, analizave dhe testeve diagnostikuese në klinika private për të moshuarit në nevojë;
    - Rikonstrukcion i shtëpive, mobilim, asete shtëpiake për të moshuarit.

### Shërbime psikologjike:

- Mbështetje psikologjike për të moshuarit në banesë dhe në qendër;
- Biseda, këshillime dhe diskutime individuale apo në grup me të moshuarit për menaxhimin e stresit, vetmisë, etj.;
- Mbështetje psikologjike për familjarët/bashkëshortët e moshuar;

## GRUPET PËRFITUESE

- **Kategoritë përfituese** ➤ Të moshuarit (65+)
- **Kriteret kualifikuese**
  - Të moshuar që jetojnë vetëm;
  - Të moshuar me të ardhura të pamjaftueshme;
  - Të moshuar në kushte të vështira jetese (banesa të amortizuara);
  - Të moshuar me sëmundje kronike në stad të avancuar;
  - Të moshuar të sëmurë me kancer në stad të avancuar.
- **Identifikimi i përfituesve** ➤ Identifikimi bëhet përmes institucioneve koordinuese (të përshkruara sa më poshtë)

## INFORMACION ADMINISTRATIV

- **Numri i punonjësve** ➤ 4 punonjës
- **Financuesi i shërbimit**
  - Fonde të Fondacionit A2B UK
  - Kisha Ungjillore UK
  - Donatorë Gjermane
  - FSCI UK
- **Burime të tjera të ardhurash** ➤ Nuk ka
- **Pagesa nga përfituesit** ➤ Nuk ka
- **Koordinimi me shërbime të tjera**
  - Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale në Bashkinë Elbasan
  - Njësitë Administrative, zonat rurale dhe lagjet
  - Drejtoria Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror
  - Klinika Mjekësorë ABC
  - Mjekë të huaj nga Britania e Madhe
  - Mjekë Specialistë në Qendrën Studentore Universitare Tiranë
  - Organizata Jofitimprurëse
  - Organizata me Bazë Fetare
  - Komuniteti

## ○ Fondacioni Aid to Balkans (A2B)

1. Qendra Sociale Ditore “Hope for the Future”
2. Apartamente sociale për të rinjtë “Shtëpia e Mundësive”

**Lloji i institucionit** Fondacion

**Adresa** Rruga “Petraq Popa”, Lagjja, “Brigada 17 Sulmuese”, Elbasan

**Përfaqësues ligjor i institucionit** **Alketa Hasani:**

Cel.: 00355 69 40 16712 | Email: alketa.hasani@a2balbania.org  
Facebook: A2B Albania

**Personi i kontaktit** **Perikli Hida:**

Cel.: 00355 68 80 63222

**Mbulimi gjeografik** Bashkia Elbasan

**Koha e ofrimit të shërbimit** Prej vitit 2016

## ○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

○ **Qëllimi i shërbimit**

➤ Jetesë me dinjitet për familjet, fëmijët dhe të rinjtë në nevojë.

○ **Fushat e shërbimeve**

- Shërbime ditore për fëmijët
- Shërbime mbështetëse për familjet
- Shërbime rezidenciale dhe integruese për të rinjtë
- Shërbime psiko-sociale

○ **Llojet e shërbimeve**

**Qendra Sociale “Hope for the Future”:**

- Kopsht për fëmijët nga familje vulnerabël;
- Programe passhkollore për fëmijët;
- Ofrim i vaktit të drekës për fëmijët (në kopsht dhe ata passhkolle);
- Kujdes okulistik për fëmijët frekuentues të qendrës sociale (*pagesë e vizitës okulistike dhe syze për fëmijët në rast nevojë*);
- Shërbim psikologjik (individual dhe në grup) për fëmijët në nevojë në qendrën ditore dhe në kopsht;
- Kampe verore për fëmijë;
- Fushata sensibilizuese mbi të drejtat e fëmijëve;

### Shërbime mbështetëse për familjet:

- Trajnime të prindërve mbi prindërimin pozitiv;
- Rikonstruksion i shtëpive, mobilim, asete shtëpiake për gratë
- e veja dhe të divorcuara;
